

VENDIM
Nr. 97, datë 28.7.2015

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “YLLIAD” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 108, DATË 22.12.2010.**

Në mbështetje të neneve 16 , 20 pika “b” dhe 110 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4 pika 1 germa “g” dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.7.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtoria Juridike,

konstatoi se:

1. Shoqëria “Ylliad” sh.p.k. ka aplikuar për rinovimin e licencës nr. 111, seria T10 në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike në datën 13.5.2015, në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 23.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 74, datë 8.6.2015, miratoi fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010.

2. Në datën 15.5.2015 ka hyrë në fuqi ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3. Në ligjin nr. 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që ligji nr. 9072 datë 22.5.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015, shfuqizohet.

4. Në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vetë ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110 pika 2 të tij parashikohet se: Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Për sa më sipër dhe duke qenë se aplikimi i shoqërisë “Ylliad” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010, për një afat 5 – vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti